

VENDIM
Nr.630, datë 27.8.2004

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN ME KONCESION TË
HIDROCENTRALIT TË LANABREGASIT, TIRANË DHE PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për dhënie me koncesion të hidrocentralit të Lanabregasit, Tiranë.
2. Forma e koncesionit të jetë "ROT" (Rehabilitim-Operim-Transperim).
3. Ministria e Ekonomisë, Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit të jenë Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA), për negocimin e marrëveshjes së koncesionit dhe për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të këtij objekti dhe në grupin e vlerësimit të kenë:
 - a) Ministria e Ekonomisë 3 përfaqësues;
 - b) Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës 2 përfaqësues;
 - c) Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit 2 përfaqësues.
4. Organi Shtetëror i Autorizuar të shqyrtojë dhe të vlerësojë propozimet e paraqitura deri tani dhe ato që do të paraqiten brenda 2 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
5. Kriteret e vlerësimit të propozimeve janë:

- Vlera e investimit dhe shkalla e rehabilitimit të makinerive e pajisjeve kryesore	45 pikë;
- Koha e kryerjes së investimit	25 pikë;
.....	
- Rritja e prodhimit të energjisë elektrike	15 pikë;
.....	
- Rritja e prodhimit të ujit	15 pikë.
.....	

6. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës dhe Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano